



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

3148

Udhëzim
Nr. 6, datë 25.2.2018

PËR

**FUNKSIONET, AUTORITETIN DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË
TATIMPAGUESVE, PROCEDURAT QË DO TË ZBATOHEN PREJ TIJ NË
MBROJTJE TË INTERESAVE TË TATIMPAGUESVE, SI DHE
PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQEN NGA TATIMPAGUESIT, PËR TË
PËRFITUAR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TYRE NGA AVOKATI I
TATIMPAGUESVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 105/2 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të VKM nr.648, datë 28.07.2010 “Për Avokatin e Tatimpaguesve”, të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim ka për qëllim rregullimin e procedurave që duhet të ndiqen nga Avokati i Tatimpaguesve dhe tatimpaguesit për, zbatimin e nenit 105/2 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të Vendimit nr.648 të Këshillit të Ministrave, datë 28.07.2010 “Për Avokatin e Tatimpaguesve”, të ndryshuar. Ai synon të rregullojë organizimin, funksionimin, përgjegjësitë dhe procedurat që duhet të zbatohen nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve në ofrimin e shërbimit ndaj taksapaguesve në mbrojtjen e të drejtave të tyre në përputhje me dispozitat e përcaktuara në legjislacionin tatimor. Gjithashtu, ky udhëzim përcakton dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, me qëllim përfitimin e shërbimit nga Avokati i Tatimpaguesve.

Rregullimet e përshkruara në këtë udhëzim për Avokatin e Tatimpaguesit, synojnë të japin, në mënyrë të qartë e të detajuar, rolin, përgjegjësitë dhe kompetencat, si edhe procedurat administrative për t’u ndjekur nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit.

1. Misioni i Avokatit të Tatimpaguesit

1.1. Avokati i Tatimpaguesve ka për mision të mbrojë interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatimore. Ky mision realizohet kryesisht nëpërmjet

kompetencës së tij për të investiguar të gjitha kërkesat e tatimpaguesve, që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektimi i procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë. Ai ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e të gjitha verifikimeve apo hetimeve në drejtoritë rajonale tatimore dhe/ose drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe nëpërmjet kompetencave këshillimore tek autoritetet kompetente për zgjidhjen e problemeve të tatimpaguesve. Çdo vendim për të ndërmarrë masat korrigjuese i takojnë administratës tatimore dhe jo Avokatit të Tatimpaguesve. Avokati i Tatimpaguesve, në rast se nuk gjen zgjidhje për një çështje të caktuar, gëzon të drejtën ta ngrejë nivelin e verifikimit dhe të investigimit deri në nivelin më të lartë të drejtimit të administratës tatimore, që është Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

1.2. Avokati i Tatimpaguesve, në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të tij është i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit dhe e ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave të tatimpaguesve.

1.3. Avokati i Tatimpaguesve promovon të drejtat e tatimpaguesve. Ai ka një rol të rëndësishëm në grumbullimin dhe në përhapjen e informacionit, lidhur me të drejtat e tatimpaguesve dhe edukimin e tyre.

1.4. Avokati i Tatimpaguesve siguron një informacion nga rastet e trajtuara, bën analiza përgjithësuese dhe ua prezanton ato hallkave administrative përkatëse, duke propozuar dhe rrugët për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e procedurave.

2. Organizimi i Avokatit të Tatimpaguesit

2.1. Avokati i Tatimpaguesve është strukturë e pavarur në vendimmarrje në përbërje të ministrisë përgjegjëse për financat. Funksionimi i strukturës së Avokatit të Tatimpaguesve është i organizuar në nivel drejtorie, në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve fiskale. Gjithashtu, ai raporton dhe informon mbi veprimtarinë e tij dhe përpara Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për financat.

2.2. Avokati i Tatimpaguesve emërohet sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Ai raporton drejtpërdrejt përpara Drejtorit të Përgjithshëm në varësi të të cilit është nga ana funksionale, Sekretarit të Përgjithshëm dhe ministrit përgjegjës për financat dhe funksionon në cilësinë e përfaqësuesit direkt të tyre, në marrëdhëniet me administratën tatimore dhe me publikun. Ashtu si Sekretari i Përgjithshëm apo ministri përgjegjës për financat, ai gëzon autoritetin unik për t'u marrë drejtpërdrejt me drejtuesit dhe punonjësit në të gjitha funksionet e të gjitha niveleve të administratës tatimore, kur një gjë e tillë është e përshtatshme. Për të nxitur përgjegjshmërinë, është më mirë që shumica e veprimeve të fillojnë nga drejtuesit, edhe pse në të mirë të shpejtësisë, një gjë e tillë nuk do të jetë gjithmonë e përshtatshme.

2.3. Marrëdhëniet e punës për personelin e stafit në varësi të Avokatit të Tatimpaguesit rregullohen, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

2.4. Avokati i Tatimpaguesve mund të jetë çdo person që plotëson këto kushte:

- a) të ketë njohuri të mjaftueshme për sistemin tatimor në Shqipëri;
- b) të ketë eksperiencë pune në administratën tatimore;
- c) të shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale;
- d) të ketë aftësi të forta ndërpersonale komunikimi.

3. Funksionet, autoriteti dhe detyrat e Avokatit të Tatimpaguesit

3.1 Avokati i Tatimpaguesve ka këto funksione:

- a) evidenton, klasifikon dhe trajton me drejtësi çdo ankesë të marrë nga tatimpaguesit;
- b) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), si dhe drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve pranë DPT, për të promovuar rolin e Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit;
- c) bashkëpunon me Drejtorinë e Auditimit në ministrinë përgjegjëse për financat, si dhe me DPT-në dhe drejtoritë e saj rajonale tatimore, për të garantuar që tatimpaguesit të trajtohen apo do të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen në mënyrën e duhur nga punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me Kodin e Etikës;
- ç) ndjek dhe trajton me korrektësi çdo rast individual dhe bën mbylljen e arkivimit të tyre, vetëm pasi ankesat të jenë trajtuar e zgjidhur në përputhje me legjislacionin tatimor, dispozitat e Kodit të Etikës dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit për procedurat tatimore;
- d) bashkëpunon me strukturat përkatëse të varësisë në DPT, si të shërbimit të tatimpaguesve, të trajnimit dhe të burimeve njerëzore, me qëllim që nga përfundimet e nxjerra nga rastet e veçanta në të gjitha drejtoritë rajonale tatimore apo drejtoritë operative në DPT, të garantohet mospërsëritja e gabimeve;
- dh) bën propozime në strukturat drejtuese të drejtorive rajonale tatimore dhe DPT për fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masave administrative ndaj punonjësve të administratës tatimore, të cilët kanë shkelur dispozitat e Kodit të Etikës;
- e) i referon raste të veçanta DPT-së, konkretisht Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm ose Drejtorisë së Hetimit Tatimor, nëse informacioni apo dokumentacioni i nxjerrë tregojnë se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të hetimit administrativ ose dhe penal ndaj personit apo personave përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë shkelur të drejtat e tatimpaguesit;
- ë) i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve propozime për përmirësime në proceset e punës dhe në procedurat tatimore, si dhe lidhur me dispozitat e Kodit të Etikës, me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, reduktimin e barrës administrative dhe lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit në përmbushje të detyrimeve tatimore.

f) nxjerr rekomandime me karakter të përgjithshëm në lidhje me çështjet e identifikuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe i përdor ato si bazë për të bërë propozime për ndryshimin e legjislacionit përkatës;

g) nxjerr rekomandime me shkrim drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore dhe/ose i paraqet këto rekomandime në seancat dëgjimore administrative të mbajtura nga Drejtoria e Apelit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore;

gj) kryen monitorime periodike, për të verifikuar me anë të sondazheve përmbushjen e procesit të informimit dhe të shërbimit ndaj tatimpaguesve, në përputhje me dispozitat ligjore, rregullat dhe rregulloret e miratuara.

3.2 Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve ka si funksion parësor sigurimin e një informacioni eficient dhe prezantimin në hallkat administrative përkatëse të problemeve e të shqetësimeve të tatimpaguesve, në përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe të procedurave përkatëse administrative, si dhe garantimin e plotësimit të të drejtave të tatimpaguesve nga administrata tatimore.

3.3 Avokati i Tatimpaguesve gëzon të drejtën e njohjes dhe marrjes me shkrim nga strukturat e administratës tatimore të çdo informacioni të përgjithshëm apo të veçantë për një tatimpagues apo një grup tatimpaguesish, në çdo fazë të procesit administrativ të nisur prej tij. Ai mund të kërkojë informacion pranë çdo strukture të administratës tatimore, përfshirë Drejtorinë e Hetimit Tatimor, për atë që nuk cenohen interesat e hetimit tatimor, siç përcaktohet në dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim. Avokati i Tatimpaguesve gëzon të drejtën e njohjes dhe marrjes së informacionit edhe nga strukturat përkatëse të shqyrtimit administrativ tatimor në Ministrinë e Financave.

3.4 Avokati i Tatimpaguesve, në bazë të kërkesës së tatimpaguesit, ka të drejtë t'i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nxjerrjen e vendimeve teknike, në përputhje me përcaktimet e nenit 10 të ligjit për procedurat tatimore. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në çdo rast i kthen përgjigje të arsyetuar Avokatit të Tatimpaguesve, për marrjen parasysh ose jo të rekomandimit brenda një afati 30-ditor.

3.5 Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të hetojë apo të ndërhyjë në rastet, për të cilat tatimpaguesi është hetuar nga Hrejtoria e Hetimit Tatimor apo nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm. Avokati i Tatimpaguesve nuk autorizohet të investigojë apo të ndërhyjë në procesin e përcaktimit të detyrimit tatimor apo për raste, të cilat janë në proces.

3.6 Avokati i Tatimpaguesve është i autorizuar të hetojë dhe të ndërhyjë, nëse procesi i vlerësimit të detyrimeve tatimore apo procesi i apelit nuk kryhet në përputhje me procedurat e vendosura në ligj apo në dispozitat përkatëse nënligjore. Në çdo rast, ky autorizim kufizohet me të drejtën e sigurimit të respektimit të procedurave dhe jo në vendimet lidhur me shumat e vlerësuara të detyrimeve tatimore apo në vendimin e marrë për apelimin.

3.7 Autoriteti i Avokatit të Tatimpaguesve

3.7.1. Avokati i Tatimpaguesit është një garanci shtesë për mbrojtjen e sigurimin e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të tatimpaguesve nga ana e administratës tatimore.

3.7.2. Avokati i Tatimpaguesve monitoron procedurat administrative në veprimtarinë tatimore dhe heton pretendimet për veprime të papërshtatshme ose mungesën e veprimeve nga autoritetet tatimore, në bazë të ankesave të paraqitura ose me iniciativën e tij.

3.7.3. Avokati i Tatimpaguesve kryen detyra që lidhen me mbrojtjen e tatimpaguesve nga veprime të papërshtatshme të autoriteteve tatimore ose mosveprimi i atyre, si rezultat i të cilave preken e cenohen të drejtat dhe interesat e ligjshme të tatimpaguesve.

3.7.4. Avokati i Tatimpaguesve ndjek me përgjegjësi e përkushtim çdo rast të mbërritur në adresë të tij dhe synon marrëveshje me administratën tatimore, përkatësisht drejtoritë rajonale ose drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, masat që duhen marrë dhe procedurat që duhet të ndiqen për zgjidhjen e rasteve të paraqitura.

3.7.5. Avokati i Tatimpaguesve monitoron dhe heton vetëm procedurën e përcaktuar në ligj apo akte nënligjore dhe nuk ka kompetencë të shqyrtojë raste që kanë të bëjnë me përcaktimin e detyrimit tatimor apo raste që janë në proces apelimi.

3.7.6 Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të shqyrtojë çështje që janë subjekt i juridiksionit të drejtorive të investigimit të brendshëm dhe të hetimit tatimor, por mund të bashkëpunojë me këto struktura, në rast se vihet në dijeni të rasteve që janë objekt i punës së tyre. Në këto raste, Avokati i Tatimpaguesve mund të marrë informacion për atë që nuk çënohen interesat e hetimit.

3.7.7. Avokati i Tatimpaguesve nuk është hallkë e rishikimit administrativ tatimor dhe as nuk e zëvendëson atë. Të kontaktosh Avokatin e Tatimpaguesit për asistencë nuk e pezullon afatin kohor, brenda të cilit mund të paraqitet një apelim. Në rast konstatimi të shkeljeve të të drejtave të tatimpaguesve nga ana e administratës tatimore lidhur me zbatimin e afateve dhe procedurat, që u pengojnë, vonojnë apo mohojnë të drejtën e apelit, Avokati i Tatimpaguesve, pasi konstaton rastin pas ankimit të tatimpaguesit, ka autoritetin të kërkojë rivendosjen në afat, në përputhje me dispozitat e përcaktuara për këtë qëllim në Kodin civil dhe Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

3.7.8. Avokati i Tatimpaguesve nuk ka të drejtë të shprehet në lidhje me themelin e një çështjeje administrative tatimore, përveçse për procedurë, e cila është në proces hetimi apo apelimi e për rrjedhojë do të përfundojë me një vlerësim tatimor apo vendim nga Drejtoria e Apelit Tatimor.

3.7.9. Në marrëdhëniet me tatimpaguesit dhe në mbrojtje të të drejtave të tyre, në zbatim të legjislacionit tatimor dhe për më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri nga ana e organit tatimor, Avokati i Tatimpaguesve monitoron procedurat e ndjekura nga administrata tatimore në procesin e administrimit tatimor dhe marrëdhënies së administratës tatimore me tatimpaguesit.

3.7.10. Avokati i Tatimpaguesve merr pjesë, është i ftuar dhe është aktiv në të gjitha diskutimet për ndryshimet në proceset e punës dhe procedurat e deklarimit, vlerësimit, mbledhjes, kontrollit dhe investigimit tatimor dhe përfaqëson në këto takime interesat e tatimpaguesve. Strukturat drejtuese të administratës tatimore duhet ta përfshijnë atë si pjesëmarrës në diskutimet/takimet/analizat që kanë të bëjnë me politikat, nismat e reja dhe prioritetet e zhvillimit të programit të menaxhimit të të ardhurave tatimore.

3.7.11. Avokati i Tatimpaguesve merr pjesë edhe në forumet dhe organizimet e biznesit për çështje që lidhen me aspektet e administrimit tatimor, madje edhe duhet të iniciojë takime me bizneset për diskutimin e situatave të cilat kanë të bëjnë me probleme të procedurave të administrimit të tatimeve.

3.7.12. Avokati i Tatimpaguesve gëzon liri të plotë e të menjëhershme tek informacioni dhe dokumentacioni i disponuar dhe administruar nga administrata tatimore në të gjitha nivelet, për çështjet që ai ka nisur hetimin administrativ.

3.7.13. Avokati i Tatimpaguesve ka autoritet të kërkojë informacion dhe sqarime nga të gjithë punonjësit e administratës tatimore, kur informacioni i kërkuar lidhet me një çështje të caktuar dhe për të cilën është nisur një hetim administrativ prej tij.

3.7.14. Avokati i Tatimpaguesve ka autoritetin të urdhërojë:

a) *Urdhri i çështjes*: drejtoritë rajonale tatimore për kryerjen e verifikimeve dhe hetimeve, lidhur me ankesa të veçanta që i paraqiten Avokatit të Tatimpaguesit. Brenda 30 ditëve, drejtori rajonal tatimor duhet të informojë Avokatin e Tatimpaguesve se ai e ka zgjidhur problemin ose t'i kërkojë Avokatit që të bjerë dakord se provat e disponueshme tregojnë se kërkesa e tatimpaguesit për t'u çliruar nga hetimi, është pa vend.

b) *Urdhri i procedurës*: drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duhet të shqyrtojnë procedurat ekzistuese, të cilat mund të jenë duke shkaktuar probleme të pajustificueshme për tatimpaguesit. Brenda 30 ditëve, drejtorët funksionalë duhet të informojnë Avokatin, nëse ata e kanë ndryshuar procedurën ose t'i kërkojnë atij të bjerë dakord se ndryshimi nuk është i nevojshëm.

c) Në të dyja rastet këto urdhra nuk pezullojnë procedurat e shqyrtimit nga ana e drejtorive rajonale apo drejtorive funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për çështjet që janë objekt i ankimit, kërkesës apo njoftimit dhe as procedurën e ekzekutimit të akteve që kanë dalë nga administrata tatimore për ato çështje.

3.7.15. Shkresat (urdhrat), opinionet dhe rekomandimet e nxjerra nga Avokati i Tatimpaguesve, duhet të trajtohen me përgjegjësi nga hallkat përkatëse të administratës tatimore dhe të gjejnë përgjigje.

3.7.16. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor rajonal ose funksional nuk bien dakord për zgjidhjen e një problemi ose për ndryshimin e një procedure, atëherë Avokati, si përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat, duhet ta udhëzojë drejtorin rajonal që t'ia referojë çështjen zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të tatimeve për

shqyrtim dhe rishikim. Zëvendës drejtori i përgjithshëm duhet të konsultohet fillimisht me Avokatin dhe më pas duhet t'i përgjigjet atij brenda shtatë ditëve pune, lidhur me vendimin e tij.

3.7.17. Nëse zëvendës drejtori i përgjithshëm dhe Avokati i Tatimpaguesve nuk bien dakord për sa i përket një ankese për një çështje tatimore apo procedurale, Avokati do të jetë përgjegjës që të planifikojë një takim për diskutimin dhe shqyrtimin e çështjes me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, i cili merr vendimin përfundimtar. Asnjë nga palët nuk duhet të takohet me Drejtorin e Përgjithshëm në veçanti për të diskutuar pozicionin e tyre, kur pala tjetër mungon.

3.7.18. Avokati i Tatimpaguesve bën analizimin e rasteve dhe rekomandon aplikimin e procedurave të unifikuara për aspekte të caktuara të administrimit tatimor me qëllim parandalimin e praktikave të kundërshtuara nga tatimpaguesit.

3.7.19. Sipas ligjit, Avokati i Tatimpaguesve ka të drejtë të propozojë masa disiplinore për punonjësit e administratës tatimore që, nga analizimi i rasteve të procesuara prej tij, rezultojnë se kanë kryer veprime me dashje për të dëmtuar një tatimpagues apo të shkelin ligjin ose procedurat. Por, para se ta kryejë këtë gjë, Avokati i Tatimpaguesve duhet t'i paraqesë provat dhe faktet e konstatuara prej tij përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si eprori më i lartë drejtues dhe ta inkurajojë atë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme.

3.7.20. Avokati i Tatimpaguesve ka kompetencë të rekomandojë masa korrigjuese dhe po të jetë rasti, edhe ndryshime në legjislacionin tatimor apo Kodin e Etikës së Administratës Tatimore.

3.7.21. Kur gjatë procesit të hetimit administrativ të nisur nga Avokati i Tatimpaguesve për çështje të veçanta, Avokatit të Tatimpaguesit nuk i jepet informacioni i kërkuar nga individë të veçantë apo autoriteti tatimor të cilit i është drejtuar, apo nuk i vihet në dispozicion dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e provave dhe të fakteve që lidhen me çështjen e nisur, Avokati i Tatimpaguesve ka të drejtën të propozojë menjëherë fillimin e procedurës disiplinore ndaj personit apo personave pengues. Kur një veprim i tillë pengues nga individë të veçantë përbën vepër penale, ai mund të kërkojë edhe fillimin e procedimit penal për pengim të hetimit administrativ.

4. Rregullat dhe procedurat për shqyrtimin e çështjeve

4.1. Çdo tatimpagues, grup tatimpaguesish, shoqata apo institucione që mbrojnë interesat e tatimpaguesve, pretendojnë për shkelje të të drejtave dhe të interesave të të ligjshme, qofshin këto individuale apo të përbashkëta të tatimpaguesit apo tatimpaguesve, me veprime të paligjshme apo të parregullta të administratës tatimore qendrore ose me mosveprime të saj, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Tatimpaguesve dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për rregullimin e situatës, në lidhje me një të drejtë të shkelur apo të mohuar.

4.2. Për ankesat, kërkesat dhe njoftimet drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit nuk kërkohet ndonjë formë apo format i caktuar. Ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të

kërkesës. Nëse disponohen, dokumente, fakte dhe prova, të cilat mendohet se mbështesin objektin e ankimimit, ato duhet t'i bashkëngjiten ankesës së drejtuar Avokatit të Tatimpaguesve.

4.3. E drejta për t'u ankuar te Avokati i Tatimpaguesve lind vetëm pasi të jetë konsumuar një herë me shkrim e drejta për t'u ankuar te drejtoria rajonale përkatëse apo drejtorinë funksionale brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilat kanë nën juridiksion shqyrtimin/administrimin e procedurës së kontestuar nga ankimuesi.

4.4. Nëse tatimpaguesi ankues/kërkues nuk ka marrë përgjigje apo zgjidhje nga hallka e parë brenda 30 ditëve nga dita e depozitimit të shkresës kërkuese, mund t'i kërkojë apo të njoftojë me shkrim Avokatin e Tatimpaguesve, në lidhje me procedurën të cilën konteston dhe pretendon që shkel të drejtat apo interesat e tij. Dita e depozitimit të kërkesës në organin tatimor do të konsiderohet:

a) Dita e dhjetë pas nisjes së kërkesës me rrugë postare, duke filluar nga dita e dorëzimit të saj në zyrën e shërbimit postar;

b) Dita e konfirmimit të marrjes dorazi të kërkesës nga zyra e protokollit përkatës në drejtorinë rajonale tatimore apo Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kur kërkesa dorëzohet dorazi nga tatimpaguesi apo grupi i tatimpaguesve;

c) Dita e dërgimit të kërkesës me postë elektronike (email), në rast se kërkesa dërkohet në rrugë elektronike. Në këtë rast, kërkesa duhet të niset në adresën elektronike përkatëse të kontakteve, të njoftuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve apo të drejtorisë rajonale tatimore.

4.5. Avokati i Tatimpaguesve, pasi i mbërrin ankesa, kërkesa apo njoftimi për një shkelje apo procedurë të kontestuar, e protokollon atë në një regjistër të veçantë të administruar nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve.

4.6. Regjistrimi i veçantë i shkresave të mbërritura në adresë të Avokatit të Tatimpaguesve bëhet me qëllim të lehtësimit të procedurave të mbërritjes së ankesave apo njoftimeve, si edhe me qëllim analizimin e rasteve të njoftuara në atë drejtori.

4.7. Shkresat e procesuara nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve firmosen nga Avokati i Tatimpaguesve dhe mbajnë vulën e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, ku veç shënimit të termit të ministrisë përgjegjëse për financat, vendoset dhe shënimi "Avokati i Tatimpaguesve".

Vula e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesve përdoret vetëm për korespondencën shkresore të kësaj drejtorie me tatimpaguesit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe organeve tatimore, si dhe me institucione apo organe qendrore, kur korespondenca shkresore lidhet vetëm me zbatimin e detyrave të kësaj drejtorie.

4.8. Pasi njihet me ankesën, kërkesën apo njoftimin për një shkelje, Avokati i Tatimpaguesve vendos:

a) të pranojë çështjen për shqyrtim;

b) të mos pranojë çështjen për shqyrtim.

4.9. Në rast të mosfillimit të shqyrtimit të një çështjeje nga ana e Avokatit të Tatimpaguesit për një nga arsyet që e përligjin mosfillimin, ky vendim duhet t'i njoftohet kërkuarit së bashku me arsyen brenda 5 (pesë) ditëve nga regjistrimi i çështjes. Nëse gjatë shqyrtimit të ankesës, vërehet se çështja nuk mund të shqyrtohet për shkak të mos shoqërimit me dokumenta, prova apo fakte, të cilat bëhen të ditura në ankesën drejtuar Avokatit të Tatimpaguesve, por që nuk i janë të bashëngjitura ankesës, në shkresën e mospranimit të ankesës, Avokati i Tatimpaguesve i kërkon ankimuesit të plotësojë ankesën e tij edhe me këto prova apo fakte, që pretendohet se janë, me qëllim rimarrjen në shqyrtim të ankesës.

Për përshpejtimin e rishqyrtimit të ankesës, një komunikim i tillë mund të bëhet edhe në rrugë elektronike apo dhe telefonike, nëse ankimuesi ka dhënë edhe adresë kontakti në ankimin e tij.

Vetëm kur çështja e ankimuar nuk përbën objekt shqyrtimi nga Avokati i Tatimpaguesve, vendimi për refuzimin bëhet me shkrim, ku sqarohet edhe arsyeja, apo argumentet se përse çështja nuk mund të shqyrtohet nga Avokati i Tatimpaguesve. Kjo nuk e pengon Avokatin e Tatimpaguesve, kur është e mundur, në përgjigjen e tij të japë dhe rekomandime lidhur me procedimin e mëtejshëm nga ankimuesi për të kërkuar zgjidhjen e çështjes së ngritur prej tij.

Vendimi i Avokatit për mosfillimin e çështjes nuk apelohej, por mund t'i drejtohet një drejtuesi më të lartë për t'u rishikuar.

4.10. Avokati i Tatimpaguesve e fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar.

Avokati i Tatimpaguesve ka autoritetin të nisë me vetëiniciativë një çështje, për raste të veçanta kur ato bëhen publike, apo kur vihet në dijeni se ka ndodhur një shkelje, e cila është në objektin e punës së tij.

4.11. Në rast të plotësimit të kushteve për pranimin e ankesës apo kërkesës, Avokati i Tatimpaguesve njofton të interesuarit, duke u kthyer përgjigje me shkrim, me e-mail apo telefon, brenda 10 ditëve nga dita e regjistrimit të ankesës, kërkesës ose njoftimit dhe, sipas rastit, e njofton tatimpaguesin se ka nisur një procedurë hetimore që mund të zgjasë më shumë.

Nëse e gjykon të nevojshme, Avokati i Tatimpaguesve mund ta thërrasë ankimuesin në takim, për të dëgjuar pretendimet e tij, si dhe për të kërkuar më tepër shpjegime lidhur me çështjen për të cilën ankimohet. Në rast të tillë mbahen shënime përkatëse, të cilat përfshihen në dosjen e hapur për shqyrtimin e çështjes së ankimuar. Në shënime përkatëse shënohet data dhe ora, kur është zhvilluar takimi me ankimuesin. Në këtë rast, tatimpaguesi mund të thirret për t'u dëgjuar në çdo periudhë kohore brenda shqyrtimit të çështjes së ankimuar prej tij. Nëse është e nevojshme, tatimpaguesi mund të thirret përsëri për të dëshmuar pretendimet e tij lidhur me çështjen në shqyrtim, përpara afatit

të marrjes së vendimit nga Avokati i Tatimpaguesve për të mbyllur hetimin administrativ dhe mbylljes së dosjes.

4.12. Në rastet kur ankesa apo kërkesa kërkon zhvillimin e një verifikimi apo hetimi nga një drejtori tatimore rajonale, Avokati i Tatimpaguesve, jo më vonë se 15 ditë nga data e regjistrimit të ankesës, i dërgon drejtorisë përkatëse rajonale tatimore një shkresë (urdhër për rishikim praktike), në të cilën jepen të dhëna të sakta identifikuese të ankimuesit, përfshirë problemet që duhet të verifikohen apo zgjidhen, duke vënë dhe afate konkrete për kryerjen e verifikimeve apo zgjidhjen e problemeve. “Urdhri për rishikimin e një praktike”, i lëshuar nga Avokati i Tatimpaguesve për drejtorinë rajonale tatimore përkatëse, do të ketë formën sipas modelit nr.1, bashkëngjitur. Avokati i Tatimpaguesve vendos nëse duhet t’i bashkëngjisë ose jo “Urdhrit për rishikimin e një praktike”, kopje të ankesës apo dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ankimuesi.

4.13. Drejtoria rajonale tatimore duhet të kryejë hetimet e nevojshme dhe të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Avokatit të Tatimpaguesit, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së shkresës (urdhrit) nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit. Në përgjigjen me shkrim, drejtoria rajonale tatimore duhet të shprehë qëndrimin e saj lidhur me zgjidhjen ose jo të rastit të ankimuar, duke dhënë dhe argumenta, si dhe, nëse shihet e nevojshme, të shoqëruar me dokumentacion provues mbi qëndrimin e saj, kur nuk nuk është dakord me pretendimin mbi ankimimin e tatimpaguesit, apo kur nuk jepet dot zgjidhje prej saj.

4.14. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor rajonal nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri rishikimi praktike”, Avokati i Tatimpaguesve dhe drejtori rajonal do t’ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të përgjithshëm që mbulon drejtorinë rajonale në fjalë.

Zëvendësdrejtorit të përgjithshëm i vihen në dispozicion shkresërisht, përveç ankesës së tatimpaguesit edhe të gjitha provat, faktet dhe dokumentat e mbledhura, mbi të cilat shkrehen qëndrimet e Avokatit të Tatimpaguesve dhe drejtuesit të drejtorisë rajonale përkatëse.

4.15. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm territorial përkatës nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri rishikimi praktike”, rasti i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, sëbashku me të gjitha provat, faktet dhe qëndrimet gjatë shqyrtimit të rastit të ankimuar. Avokati i Tatimpaguesve, në varësi të fakteve, provave dhe qëndrimit të tij, mund të shprehë edhe rekomandimet e veta lidhur me gjetjet dhe zgjidhjen e çështjes.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pasi shqyrton çështjen e ankimuar, si dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe qëndrimin e shprehur nga Avokati i Tatimpaguesve, Zëvendësdrejtori i përgjithshëm dhe drejtoria rajonale tatimore, shprehet zyrtarisht me qëndrimin e tij mbi ankesën a tatimpaguesit.

Qëndrimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve i bëhet i ditur zyrtarisht tatimpaguesit që ka bërë ankesën, brenda 15 ditëve nga marrja e përgjigjes zyrtare. Në rast se çështja e ankimuar nuk merr zgjidhje nga adimintrata tatimore, por për zgjidhjen e saj është e

nevojshme shqyrtimi në rrugë gjyqësore, Avokati i Tatimpaguesve i rekomandon tatimpaguesit të ndjekë rrugën e zgjidhjes nëpërmjet ankimimit në gjykatën administrative.

4.16. Në rastet kur një ankesë lidhet me një procedurë tatimore që duhet të trajtohet nga një drejtori funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Avokati i Tatimpaguesve përgatit një shkresë (urdhër rishikimi procedural) që i drejtohet drejtorisë përkatëse funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Urdhri i rishikimit procedural do të hartohet sipas modelit nr.2 bashkëngjitur.

4.17. Drejtoria funksionale përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duhet t'i përgjigjet Avokatit të Tatimpaguesit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së urdhrat për rishikim procedural.

4.18. Nëse Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor funksional në DPT nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një "Urdhri për rishikim të një procedure", Avokati i Tatimpaguesve dhe drejtori funksional do t'ia paraqesin rastin zëvendës drejtorit të përgjithshëm që mbulon drejtorinë funksionale përkatëse.

Zëvendës drejtorit të përgjithshëm i vihen në dispozicion shkresërisht, përveç ankesës së tatimpaguesit edhe të gjitha provat, faktet dhe dokumentat e mbledhura, mbi të cilat shkrehen qëndrimet e Avokatit të Tatimpaguesve dhe të drejtorisë përkatëse në DPT.

4.19. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendës drejtori i përgjithshëm funksional nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një "Urdhri për rishikim procedure", rasti i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, sëbashku me të gjitha provat, faktet dhe qëndrimet gjatë shqyrtimit të rastit të ankimuar. Avokati i Tatimpaguesve, në varësi të fakteve, provave dhe qëndrimit të tij, mund të shprehë edhe rekomandimet e veta lidhur me gjetjet dhe zgjidhjen e çështjes.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pasi shqyrton çështjen e ankimuar, si dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe qëndrimin e shprehur nga Avokati i Tatimpaguesve, Zëvendës drejtori i përgjithshëm dhe drejtoria përkatëse në DPT, shprehet zyrtarisht me qëndrimin e tij mbi ankesën a tatimpaguesit.

Qëndrimi i Drejtorit të Përgjithshëm i bëhet i ditur zyrtarisht tatimpaguesit që ka bërë ankesën, brenda 15 ditëve nga marrja e përgjigjes zyrtare. Në rast se çështja e ankimuar nuk merr zgjidhje nga adimintrata tatimore, por për zgjidhjen e saj është e nevojshme shqyrtimi në rrugë gjyqësore, Avokati i Tatimpaguesve i rekomandon tatimpaguesit të ndjekë rrugën e zgjidhjes nëpërmjet ankimimit në gjykatën administrative.

4.20. Avokati i Tatimpaguesve duhet të ruajë konfidencialitetin për informacionin e dhënë nga ankimuesi, duke mos e paraqitur atë të plotë te drejtoria rajonale me të cilën lidhet ankimimi, për sa e gjykon të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën, kërkesën apo njoftimin.

4.21. Me përfundimin e procedurës së rishqyrtimit, jo më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të rishqyrtimit, Avokati i Tatimpaguesve bën njoftimin e ankimuesit

nëpërmjet një opinioni përmbledhës me rezultatet e rishqyrtimit dhe mbyll praktikën duke bërë edhe arkivimin e saj. Nëse tatimpaguesi është i kënaqur nga zgjidhja e çështjes, ky njoftim mbylljeje mund të bëhet dhe me gojë. Data dhe ora e njoftimit me gojë duhet të regjistrohet në kopjen e urdhrat të mbylljes që ndodhet në zyrën e Avokatit.

4.22. Administrimi i kërkesave, njoftimeve apo ankesave të mbërritura tek Avokati i Tatimpaguesve bëhet nëpërmjet një programi kompjuterik, i cili në çdo kohë mund të japë informacion në lidhje me ankuesin, objektin e ankimit, ecurinë e trajtimit nga Avokati i Tatimpaguesve, që nga marrja në shqyrtim e deri te mbyllja e çështjes me shënimet përkatëse të arsyeve dhe rezultateve të mbylljes.

4.23. Në asnjë rast ankimi, kërkesa apo njoftimi i depozituar pranë Avokatit të Tatimpaguesit nuk e pezullon procedurën e shqyrtimit nga ana e drejtorive rajonale apo drejtorive funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për çështjet që janë objekt i ankimit, kërkesës apo njoftimit dhe as procedurën e ekzekutimit të akteve që kanë dalë nga administrata tatimore për ato çështje.

4.24. Çdo shërbim që ofrohet nga Avokati i Tatimpaguesve është pa pagesë.

5. Raportimi

5.1. Avokati i Tatimpaguesve raporton periodikisht te Drejtori i Përgjithshëm në ministri që e ka në varësi hierarkike, si dhe çdo tre muaj Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë dhe ministri përgjegjës për financat. Një kopje të raportit, Avokati i Tatimpaguesit ia dërgon dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. .

5.2. Përveç raportimit të zakonshëm, Avokati i Tatimpaguesve i raporton eprorëve të hierarkisë dhe ministrit përgjegjës për financat, sa herë që i kërkohet prej tyre.

5.3. Në rastet kur e gjykon të arsyeshme, Avokati i Tatimpaguesve ka të drejtë të kërkojë të raportojë te eprorët e hierarkisë funksionale dhe ministri përgjegjës për financat për situata apo çështje të veçanta, përveç raportimit periodik.

5.4. Raportimi i Avokatit të Tatimpaguesve duhet të përfshijë:

5.4.1 Të dhëna cilësore lidhur me:

i) Numrin e ankesave të marra, të pranuar për investigim që lidhen me çështjet dhe numrin e atyre të refuzuara. Numrin e çështjeve të mbyllura. Numrin e çështjeve që mbeten të hapura dhe përqindjen e atyre që janë të vjetra. Numrin e çështjeve për të cilin ankesa e tatimpaguesit është përcaktuar e pavlefshme. Numri i çështjeve të mbyllura, ku vendimi ka qenë në favor të tatimpaguesit dhe volumi i çështjeve sipas funksionit, do të raportohen gjithashtu.

ii) Numri i urdhrave proceduralë për shqyrtim që janë lëshuar, mbyllur, mbeten të hapur, si dhe përqindja e urdhrave të vjetër. Numri i urdhrave të mbyllur proceduralë për shqyrtim, ku vendimi përfundimtar është mbështetur nga rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit.

iii) Numri i herëve që Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendësudrejtori i përgjithshëm kanë rishikuar një rast të shqyrtuar apo një urdhër të ndryshuar dhe kanë arritur apo jo në një marrëveshjeje.

iv) Për raportin tremujor që i drejtohet Ministrisë së Financave, raporti duhet të përcaktojë numrin e herëve që Drejtorit të Përgjithshëm i është kërkuar të japë një vendim përfundimtar deri në atë masë sa rezultati është mbështetur nga pozicioni i zëvendësudrejtorit të përgjithshëm apo ai i Avokatit.

5.4.2. Problematika dhe çështje që lidhen me politikat e administrimit:

i) Përshkrim të problemeve që hasen më shpesh, shkaqet e tyre dhe veprimet e nevojshme për të pakësuar problem të ngjashme në të ardhmen.

ii) Raporti do të identifikojë gjithashtu çështje të ligjit dhe politikës që rritin përgjegjësinë ndaj tatimpaguesve, të cilët tentojnë të përmbushin vullnetarisht detyrimet tatimore.

5.5. Raportet përshkruajnë takime dhe forume në sektorin privat, ku Avokati i Tatimpaguesve apo personeli i tij kanë bërë prezantime dhe kanë kërkuar opinionin e tatimpaguesve.

5.6. Raporti do t'i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm dhe ministrit përgjegjës për financat brenda datës 20 të muajit që pason çdo tremujor në kalendar.

5.7. Në fund të çdo viti, por jo më vonë se data 31 janar e vitit pasues, Avokati i Tatimpaguesve harton dhe paraqet përpara ministrit përgjegjës për financat raportin vjetor të punës njëvjeçare, lidhur me rastet e trajtuara, evidentimet e problematikave, rezultatet e arritura, si dhe për rekomandimet e dhëna.

5.8. Avokati i Tatimpaguesve ndërton dhe faqen e vet elektronike në Website të ministrisë përgjegjëse për financat, me qëllim promovimin e punës dhe problematikave që ndjek si institucion në mbrojtje të të drejtave të tatimpaguesve.

6. Shfuqizime

Udhëzimi nr.37, datë 05.11.2010 shfuqizohet.

7. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1 Janar 2019

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË

Anila Denaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

AVOKATI I TATIMPAGUESVE

Nr. ____/____ Prot

Tiranë, më ____/____/201__

Lënda: Urdhër për rishikim praktike.

DREJTORISË RAJONALE TATIMORE

Adresa: Rruga ".....",

I nderuar Z./Znj.

Avokati i Tatimpaguesve po shqyrton ankesën e tatimpaguesit
me NIPT/NUIS lidhur me problemin
.....

Bazuar në dispozitat e Udhëzimit Nr. të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë
..... "Për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati
i Tatimpaguesve dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit, urdhëroj kryerjen e
verifikimeve të nevojshme dhe shqyrtimin e problemit që vijon:

Përshkrimi i ankesës:
.....
.....

Përsa më sipër, bazuar në dispozitat e udhëzimit të sipërpërmendur, lutemi na dërgoni
rezultatet e shqyrtimit të praktikës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e këtij
urdhëri.

Ju faleminderit.

AVOKAT I TATIMPAGUESVE

.....

Konceptoi:

Datë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

AVOKATI I TATIMPAGUESVE

Nr. ____/____ Prot

Tiranë, më ____/____/201__

Lënda: Urdhër për rishikim procedural.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

DREJTORISË SË

Adresa: Rruga "Gjin Bue Shpata", TIRANË

I nderuar Z./Znj.

Avokati i Tatimpaguesve po shqyrton ankesën e tatimpaguesit
me NIPT/NUIS, ose ankesën e institutit shoqatës/përfaqësisë së
tatimpaguesve etj., lidhur me problemin

Bazuar në dispozitat e Udhëzimit Nr. të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë
..... "Për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga
Avokati i Tatimpaguesve dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit, urdhëroj
rishikimin e procedurës:

.....
.....
.....

Bashkëngjitur janë fakte dhe argumente lidhur me këtë ndryshim.

Përsa më sipër, bazuar në dispozitat e udhëzimit të sipërpërmendur, lutemi na dërgoni
rezultatet e shqyrtimit të praktikës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e këtij
urdhëri.

Ju faleminderit.

AVOKAT I TATIMPAGUESVE

.....

Konceptoi:

Datë: